



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:233411

Datë: 19.05.2020

Numri i dokumentit: 00924312

C.nr.1023/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Mevlide Shabani,, në çështjen kontestimore të paditëses Sh.B nga Gjilani, rr. "....." nr....., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit S.S, avokat nga Kamenica, kunder të paditurës Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor me autorizim A.M nga Gjilani, me objekt kontesti- kompenzim i pages dhe ushqimi ditor, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më date 02.03.2020, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses Sh.B, nga Gjilani dhe **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Gjilanit –Drejtoria Komunale për Arsim, që paditëses t’ia kompenzoj në emër të shpërblimit të një page jubilarë (75%) shumë prej **315.75€**si dhe në emër të kompenzimit për ushqimin gjatë ditëve të punës nga data 18.04.2017 e deri në ditën e pensionimit më 25.05.2019, për 391 ditë pune, shumë prej **782.00€**, (391x2=782), e në shumë totale prej **1,097.75€**(një mijë e nëndëdhjet e shtatë euro e shtatëdhjet epesë cent), me kamatë ligjore prej 8 %, duke e llogaritur nga dita e ncjerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive të sajë , në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbartimit .

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilant –DKA, që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 260,00 € të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas datës së pranimit të këtij Aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbartimit.

A r s y e t i m i

Paditësja, Sh.B nga Gjilani, përmes të autorizuarit të saj S.S av. Nga Kamenica, në këtë gjykatë ka paraqitur padi pranë kësaj gjykate me datë 15.10.2019, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, për pagesën e një page jubilarë .

I autorizuari i paditëses me parashtresën e datës 20.02.2020, e ka precizuar padinë në aspektin objektiv dhe përpos një page jubilarë (në shumë prej 75%), në shumë prej 340.50€ ka kërkuar edhe kompenzimin e ushqimit gjatë ditëve të punës nga data 18.04.2017 e deri në ditën e pensionimit më datë 25.05.2019, për një ditë punë 2€ konform nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Në shqyrtimin gjyqësor ka mbetur në tersi pranë padisë si dhe precizimit të padisë në kuptimin objektiv, duke e ndryshuar vetëm shumën e kërkesës sa i përket pagesës për shpërblim jubilar si dhe dhe shpenzimet e ushqimit për ditët e pranisë në punë, duke zbritur pushimet vjetore dhe ditët e festave dhe atë: në emër të shpërblimit jubilar për përvojën e punës mbi 20 vite prej 75% të pagës bazë në shumë prej 315.75euro/cent, si dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën nga

data 18.04.2017 e deri 25.05.2019, për 391 ditë mësimore shumën totale prej 782.00€ e në shumën totale prej 1,097.75€ me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga data e dorëzimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e proceurës gjyqësore duke i specifikuar, e në lartësinë prej 260 euro.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më datën 11 .11.2019, të cilën e paditura e ka pranuar më datën 13.11.2019 (e cila datë është vërtetuar përmes flete kthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do ti ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të merr aktgjykim për shkak të mosbindjes.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës në përgjigje në padi, në plotësimin e përgjigjes në padi, si dhe në shqyrtimin gjyqësor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar në ligj, duke theksuar që Komuna e Gjilanit- DKA nuk është përgjegjëse që nuk janë siguruar mjetet financiare që rrjedhin nga kontrata kolektive e nënshkruar nga Qeveria e Kosovës dhe SBASHK-u. Gjithashtu ka theksuar që pagat jubilarë sipas kontratës kolektive mund të realizohen pas çdo 10 viteve dhe se afati i realizimit i kërkesës është 30 ditë nga koha e të drejtës për kompensim e që në rastin konkret ka tejaklim të afatit ligjor të realizimit të kërkesës si dhe e ka kundërshtuar edhe sa i përket shumës së kërkuar për pagimin e ushqimit ku thekson që sipas kontratave të punës parashihet për mësimdhënës që ti ketë 20 orë në javë, orë pune dhe 20 orë në javë orë mësimi e që në vërtetim nuk qartësohet ky fakt si dhe që i mungon baza ligjore sipas ligjit të punës dhe kontratës kolektive në fuqi si dhe i ka kundërshtuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Po ashtu ka theksuar se kjo kërkesë është parashkruar nga arsyeja se në vërtetimin e DKA-së i dt. 29.05.2019, vërtetohet se paditësja ka përvojë pune gjithsej 24 vite e 7 muaj e 10 ditë që i bie se çdo kërkesë e natyrës periodike parashkruhet në afat prej 3 vitesh në nazë të LMD-së dhe Ligjit të Punës.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Aktvendimi për nderprerjen e marrëdhënies së punës me numër të protokollit 49840 i dt. 06.05.2019 e lëshuar nga DKA në Gjilan, vërtetimi mbi përvojën e punës me nr. të protokollit 59589 i datës 29.05.2019 i lëshuar nga DKA në Gjilan, lista e pagave e muajit Mars, Prill dhe Maj e vitit 2019, e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetimi për ditët e përvojës së punës me nr. të protokollit 56/2020 i dt.18.02.2020 i lëshuar nga SHFMU’’ Rexhep Elmazi’’ në Gjilan.

Gjykata analizoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-ës dhe vërtetoi se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj edhe atë :

Nga Aktvendimi mbi nderprerjen e marrëdhënies së punës me numer të protokollit 49840 e datës 06.05.2019, gjykata vërtetoi faktin se paditëses i është nderprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore.

Nga vërtetimi mbi përvojën e punës me numër të protokollit 59589 i dt. 29.05.2019 e lëshuar nga Drejtoria e SH.F.M.U. “ Rehxhep Elmazi “ në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se nga kalendari për vitin shkollor të pranisë në punë të mësimdhënësës –paditëses për vitin 2017 ka mbajtur 41 orë pune, në vitin 2017-2018, ka mbajtur 185 orë punë, në vitin 2018 -2019 , ka mbajtur 165 orë punë, e që gjithsejt ka mbajtur 391 orë punë gjegjësisht ditë të pranisë në punë

në cilësi të mësimdhënëses, andaj kur këto ditë të shumëzohen me nga dy ("2) euro në ditë japin shifren prej prej 782.00€ për mësimdhënësen.

Në fakt në mes palëve ndërgjyqësore nuk ishte kontestuese fakti se paditësja është punëtore e arsimit në SHFM "Rexhep Elmazi" në Gjiilan, pastaj fakti se nuk i është paguar shpërblimi jubilar bazuar në përvojën e punës dhe nuk i është paguar ushqimi nga dy euro për çdo ditë pune dhe për këtë arsye gjykata nuk i arsyetoi ma tepër, ngase faktet që pohohen apo nuk kundërshtohen nuk kanë nevojë ma detalisht të arsyetohen, kurse fakti se e paditura nuk ka mjete buxhetore për pagesë të shpërblimit jubilar dhe pagesën për ushqimin e tyre, nuk janë fakte meritore në vendosjen e çështjes, andaj edhe nuk ka nevojë ma tepër të arsyetohen.

Andaj, duke u bazuar në një gjendje të tillë të pakontestueshme e në mbështetje të nenit 35.7 dhe 8 të Kontrarës Kolektive të Arsimit në Kosovë (Kontrata nr. 24 e datës 18 prill 2017) gjykata e ka miratuar kërkesëpadinë e paditëses të bazuar me ligj, ngase në marrëdhëniet e detyrimeve debitori dhe kreditori kanë detyrime që me ndërgjegjëje dhe pa vonesë ti përmbushim detyrimet reciproke e në rast të mospërmbushjes lindë e drejta e kreditorit që të kërkojë nga debitori, pos përmbushjen e detyrimit edhe dëmin eventual që pëson kreditori për shkak të vonesës. Një detyrim i tillë shprehimisht është përcaktuar në nenin 245 të LMD (Ligji nr.04/L-077 i datës 10 maj 2012 0 citat "kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushi atë me ndërgjegjëje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij. 2. Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak.

Pretendimet e të autorizuarit të të paditurës se ekziston parashkrimi për të kërkuar njohjen e një të drejtë të tillë, sa i përket pagës jubilarë, gjykat konstaton që një pretendim i tillë është pa bazë ligjore sepse paditësja ka filluar punën më datën 01.09.1999, ndërkaq me dt. 25.05.2019, ka dal në pension, në kohën kur i ka mbushur 65 vite e që në rastin konkret nuk kemi parashkrim të kërkesës, pasi që paditësja padinë në gjykatë e ka dorëzuar me dt. 15.10.2019, që do të thotë se padia është doeruar pas 5 muajve nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore, ndërsa në nenin 87 të Ligjit të Punës shprehimisht parashihet "që të gjitha kërkesat në para, parashkruhen në afat prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës".

Kamat prej 8% në vit bazën juridike e ka në nenin 282 të LMD, në të cilën shprehimisht është përcaktuar se "Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla, debitori përpos borxhit kryesor është i detyruar të paguaj edhe kamatën". Lartësia e kamatës vonësë është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçant.

Vendimi për shpenzimet e procedurës gjykata e bazoi në nenin 452 paragrafi 1 dhe 463 të LPK-së, ashtu që e detyroi që paditurën ti a kompensoj paditëses shpenzimet në shumën prej 259 euro në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi edhe ate për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, për një përfaqsim gjyqësor të avokatit shumën prej 135 euro dhe 20 euro për taksën gjyqësore.

Nga të cekurat e lartëpërmendura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1023 /2019, më datën 02.03.2020

Gjyqtarja,
Mevlide Shabani

Numri i lëndës: 2019:233411
Datë: 19.05.2020
Numri i dokumentit: 00924312

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimi të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj Gjykate.